

RREGULLORE NR. 2008/13

**MBI MIRATIMIN E BUXHETIT TË KONSOLIDUAR TË KOSOVËS DHE
SHPENZIMEVE TË AUTORIZUARA PËR PERIUdhËN 1 JANAR DERI
MË 31 DHJETOR 2008**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) nr. 1999/1, të datës 25 korrik 1999 mbi autorizimin e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Duke marrë parasysh përgjegjësitë e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes sipas neneve 5.1 (a) dhe (b) dhe nenit 5.2 (c) të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2001/9 të datës 15 maj 2001 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë,

Duke marrë në konsiderim pushtetin suprem të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm sipas nenit 8.1 (c) të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2001/9 të datës 15 maj 2001 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë për të miratuar Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës,

Duke marrë parasysh Shtojcën II të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë,

Duke marrë parasysh Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 23 janar 2003 (Ligji i ndryshuar nr. 2003/2), ashtu siç është shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/17 të datës 12 maj 2003,

Bazuar në propozimin për Buxhetin e Kosovës për vitin 2008, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe pas konsultimit me Këshillin Ekonomik dhe Fiskal,

Duke përkujtuar Urdhëresën administrative nr. 2007/14 të datës 31 dhjetor 2007 për vazhdimin e periudhës së efektshmërisë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/61 për të mbuluar dy muajt e parë të vitit fiskal 2008,

Me qëllim të miratimit të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe çështjeve të tjera të ngjashme,

Me anë të kësaj shpall si vijon:

Neni 1 Përkufizimet

Në këtë Rregullore janë të përfshira sipas referencave përkufizimet që janë në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, të shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/17, përveç të mëposhtmeve:

“Shtesat” janë pagesa shtesë për: a) detyrat specifike me përgjegjësi të veçantë; b) detyrat të cilat janë me rrezik dhe c) puna e natës e cila nuk paguhet si punë jashtë orarit;

“Ndarje buxhetore” do të thotë shuma e autorizuar ligjërisht nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës që mund të lihet në dispozicion për t’u shpenzuar qoftë për një kategori shpenzuese në kudër të një programi apo propozimi specifik ose; kur qëllimi i veçantë nuk është identifikuar për një kategori shpenzuese për një organizatë buxhetore, ashtu siç është paraqitur në pasqyrën 2 të kësaj Rregulloreje;

“Mbetje” do të thotë shumat e zotimeve të pashpenzuara, ndarjet buxhetore të paalokuara, alokimet e pazotuara dhe çfarëdo burimesh të të ardhurave që kalojnë shumën e shpenzimeve dhe zotimeve të pashpenzuara që janë bartur nga viti fiskal 2007;

“Zotimet” do të thotë shpenzimet e parashikuara për të cilat është dorëzuar urdhërpagesa e zotimit në Thesar dhe është regjistruar në regjistrin kontabël të Thesarit, pavarësisht se a i nënshtrohet obligimit ligjor apo jo;

“Pozitë e të punësuarit” do të thotë pozitë e punësimit me orar të plotë apo që është ekuivalent e me orarin e plotë ashtu siç është paraqitur në pasqyrën 2 të kësaj Rregulloreje;

“ZRE” do të thotë Zyra e Rregullatorit të Energjisë, e cila është themeluar në përputhje me Ligjin për rregullatorin e energjisë, të shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut 2004/20 të datës 30 qershor 2004;

“Kategoritë e shpenzimeve” do të thotë rrogat dhe pagat, mallrat dhe shërbimet e tjera, subvencionet dhe transferimet, shpenzimet kapitale dhe rezervat;

“Shpenzime” do të thotë pagesa të të hollave prej Fondit të Konsoliduar të Kosovës

“Alokimi fondeve” do të thotë shuma maksimale e shpenzimeve dhe e zotimeve që mund të bëhen për ndarje të caktuar buxhetore, sipas këshillës së dhënë një organizate buxhetore në fletënjoftimin e fondeve të ndara, të lëshuar nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë;

“Buxhet i Përgjithshëm i Kosovës” do të thotë buxheti i cili përfshin buxhetet e pakonsoliduara të të gjitha organizatave buxhetore të Kosovës në sektorët e aktiviteteve të Qeverisë, që përfaqësohen nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (duke përfshirë komunat) dhe kompetencat e rezervuara, si dhe ndarjet buxhetore, të cilat janë paraqitur në pasqyrën 2 të kësaj Rregulloreje;

“AKM” do të thotë Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, e themeluar në pajtim me Rregulloren e ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2002/12 të datës 13 qershor 2002;

“AKP” do të thotë Agjencia Kosovare e Pronave, e themeluar në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/10 të datës 4 mars 2006, e cila është ndryshuar përmes Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të datës 16 tetor 2006;

“Obligim” do të thotë marrëveshje ligjore, siç është kontrata apo urdhërblerja, në të cilën ka hyrë organizata buxhetore dhe e cila kërkon nga organizata buxhetore që të bëjë një shpenzim në të ardhmen;

“RTK” do të thotë Radiotelevizioni i Kosovës, i themeluar në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/14 të datës 11 prill 2006;

“Organizatat buxhetore me kompetenca të rezervuara” do të thotë organizatat buxhetore që pranojnë shuma të caktuara sipas nenit të cekur të pasqyrës 2 të tabelës B që i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje;

“Fitime të mbajtura” do të thotë shuma e mjeteve të pandara që mbesin në Fondin e Konsoliduar të Kosovës nga 31 dhjetori i vitit fiskal paraparak;

“Regjistër kontabël i Thesarit” do të thotë regjistri kontabël i themeluar brenda Thesarit të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave dhe

“Fondi i mirëbesimit” do të thotë paratë publike që mbahen nga organizata buxhetore për përfitim të personit, organit apo të ndërmarrjes përveç organizatës buxhetore.

Neni 2

Miratimi i Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitin 2008

Miratohet Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për vitin 2008 ashtu siç është paraqitur në pasqyrën 1. Ky buxhet mund të ndryshohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm me anë të një urdhërese administrative, në përputhje me dispozitat e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, i miratuar nga Kuvendi si Ligji nr. 2003/2 dhe i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut. nr. 2003/17

Neni 3

Ndarjet e buxhetit të përgjithshëm të Kosovës

3.1 Me anë të kësaj Rregulloreje autorizohen ndarjet e mjeteve nga Fondi i Konsoliduar i Kosovës për vitin fiskal 2008, siç është paraqitur në tabelat A, B dhe C të pasqyrës 2 që i janë bashkëngjitur kësaj Rregulloreje dhe shpenzimet e specifikuar në Buxhetin e Përgjithshëm të Kosovës për qëllimet e përgjithshme të paraqitura të Qeverisë dhe shumat e paraqitura në tabelën A, B dhe C të pasqyrës 2.

3.2 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të nxjerrë urdhëresë administrative për të ndryshuar pasqyrat që i janë bashkëngjitur kësaj Rregulloreje në përputhje me dispozitat e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi të shpallur me anë të Rregullores së UNMIK-ut. nr. 2003/17.

3.3 Ministri i Ekonomisë dhe i Financave mban një regjistër të të gjitha ndarjeve buxhetore të miratuara, të transferimeve të ndarjeve buxhetore ose të ndryshimeve të tjera të miratuara gjatë vitit fiskal 2008 përmes regjistrit kontabël

të Thesarit, të plotësuar sipas nevojës me shënime të tjera. Me rastin e rishikimit gjashtëmujor të buxhetit të vitit 2008 dhe raportit përfundimtar, i cili përgatitet brenda tre muajsh nga mbyllja e vitit fiskal 2008, ose në raste të tjera sipas kërkesës së Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm ose Kuvendit, Ministri i Ekonomisë dhe i Financave duhet t'i paraqesë raport gjithëpërfshirës Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, Qeverisë dhe Kuvendit, duke cekur hollësisht dhe duke barazuar ndarjet e miratuara të buxhetit fillestar 2008, të gjitha transferimet vijuese dhe ndryshimet e tjera, si dhe ndarjet përfundimtare buxhetore për vitin fiskal 2008.

Neni 4

Ndarja e mjeteve buxhetore komunale

4.1 Pavarësisht nga neni 3, ndarjet buxhetore në pasqyrën 2, tabela C, të cilat bazohen në “burimet financiare vetjake të komunave” autorizohen vetëm nëse të ardhurat e tilla janë depozituar në Fondin e Konsoliduar të Kosovës dhe janë regjistruar sipas rregullit në regjistrin kontabël të Thesarit

4.2 Në rast se të hyrat nga participimi, tarifatat, detyrimet ose tatimet e mbledhura nga komuna tejkalojnë shumën e të hyrave të ndara në tabelën C të pasqyrës 2, për një komunë të tillë do të bëhet një përshtatje shoqëruese e shumës së ndarë nga buxheti. Të hyrat e tilla të tejkaluara nuk mund të alokohen ose të shpenzohen derisa të mos bëhet një përshtatje me buxhetin e komunës nga kuvendi komunal në pajtim me procedurat e parapara me Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, të shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/17. Çdo përshtatje e tillë e të hyrave dhe e ndarjeve buxhetore evidencohet në regjistrin kontabël të Thesarit dhe përfshihet në rishikimin e ardhshëm të pasqyrave buxhetore, të miratuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm në pajtim me nenin 2 dhe 3.

4.3 Të hyrat nga pagesat dhe taksat për arsim evidencohen veçmas dhe këto të hyra mund të ndahen dhe të shfrytëzohen nga komuna vetëm për qëllime arsimore. Të hyrat nga participimi për kujdesin shëndetësor primar evidencohen veçmas dhe këto të hyra mund të ndahen dhe të shfrytëzohen nga komuna vetëm për qëllime të kujdesit shëndetësor primar.

4.4 Ndarjet buxhetore në pasqyrën 2, tabela C që bazohen në grantin stimulues për tatimin në pronë autorizohen vetëm atëherë nëse komuna fiton të drejtën për atë grant në janar të vitit 2008 bazuar në arritjen e synimit të saj për vjeljen e tatimit mbi pronë për vitin 2007 të caktuar nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave. Përshtatjet e shumave buxhetore të ndara për çdo komunë evidencohen me kohë në regjistrin kontabël të Thesarit dhe përfshihen në rishikimet pasuese të

pasqyrave të buxhetit të miratuara nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm në pajtim me nenin 2 dhe 3.

4.5 Secila komunë e cekur në pasqyrën 3 do të bëjë alokimin për bashkësitë joshumicë të asaj komune nga të hyrat vetjake dhe nga grantet e përgjithshme për arsim dhe shëndetësi të pranuar nga Buxheti i përgjithshëm i Kosovës së paku në përpjesëtimin e shënuar në pasqyrën 3, e cila mund të korrigjohet periodikisht në bashkërendim me Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë për

Ekonomi dhe Financa, Ministrinë e

Administrimit të Pushtetit Lokal dhe me kuvendet komunale përkatëse.

Rekomandimet e përbashkëta për ndonjë ripërshtatje ose rialokim të përqindjeve do t'i përcillen për miratim Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm nga Ministri për Komunitete dhe Kthim dhe nga Ministri për Ekonomi dhe Financa.

4.6 Shpenzimet e paparashikuara nuk do të përfshihen me qëllim të llogaritjes së ndarjes së drejtë financiare për arsye të vetë përkufizimit. Kjo nuk do të vlejë për shpenzimet e paparashikuara të autorizuara për të ndihmuar një komunë në realizimin e përgjegjësiave për ndarje të drejtë të financimit.

4.7 Brenda 15 ditëve nga përfundimi i çdo tremujori për vitin fiskal 2008, secila komunë përgatit dhe i dorëzon raportin financiar Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave dhe Ministrisë për Komunitete dhe Kthim lidhur me ndarjen e tyre të drejtë financiare dhe me standardet e tjera të rëndësishme në përputhje me formatet standarde të përcaktuara nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave që janë në pajtim me Udhëzimin administrativ nr. 2006/09 mbi ndarjen e drejtë financiare të komuniteteve.

4.8 Në rast se komuna nuk e përmbush përpjesëtimin e caktuar të ndarjes së drejtë financiare ose nuk u përmbahet standardeve dhe objektivave të tjera përkatëse, Ministri i Ekonomisë dhe i Financave dhe Ministri për Komunitete dhe Kthim, pasi të jetë konsultuar me Komisionin për grante, mund t'i rekomandojë Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm zbatimin e masave të cilat mund të përfshijnë mes të tjerash:

(a) Mosdhënien e shumave të ardhshme nga Buxheti i Përgjithshëm i Kosovës, duke përfshirë edhe ato nga të ardhurat vetjake të komunës derisa të mos jetë përmbushur përpjesëtimi i ndarjes së drejtë financiare;

(b) Caktimin e kriterit për komuna lidhur me shpenzimin e fondeve në dispozicion;

(c) Bartjen e drejtpërdrejtë të fondeve të bashkësitë joshumicë;

(d) Decrtifikimin e komunës në fjalë dhe

(e) Caktimin e një administratori financiar komunal në bazë të nenit 61 të Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, të shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/17, sipas nevojës.

4.9 Ministri i Ekonomisë dhe i Financave në bashkërendim të ngushtë me Ministrin për Komunitete dhe Kthim, pasi të jetë konsultuar me Komisionin për grante, mund të nxjerrë udhëzime administrative lidhur me administrimin e ndarjes së drejtë të financave për komunat.

4.10 Deri në emërimin e zyrtarëve për menaxhimin e administrimit financiar të njësive komunale pilot në përputhje me ligjin në fuqi, duke përfshirë nenin 46.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/45 dhe Urdhëresën administrative të UNMIK-ut nr. 2005/11, fondet për njësitë komunale pilot të paraqitura në pasqyrën 2, tabela C zotohen, obligohen dhe shpenzohen në pajtim me rregullat financiare të Thesarit nën drejtimin e administratorit të përkohshëm financiar. Ky i fundit emërohet për çdo njësi komunale pilot nga Ministri i Ekonomisë dhe i Financave, duke vepruar në bashkërendim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Administratori i përkohshëm financiar është përgjegjës për menaxhimin e çështjeve financiare të njësive komunale pilot nën mbikëqyrjen e Ministrit të Ekonomisë dhe të Financave.

4.11 Për ato komuna që nuk ia kanë dorëzuar Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave ndarjet e tyre buxhetore ashtu siç janë vërtetuar nga kuvendet e tyre komunale deri në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, ndarjet buxhetore të paraqitura në pasqyrën 2, tabela C nga grantet e financuara prej Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës autorizohen vetëm nëse ato komuna më pastaj i respektojnë udhëzimet për hartimin e buxhetit të vitit 2008 të nxjerra nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave gjatë vitit fiskal 2007.

Neni 5

Të hyrat vetjake të organizatave të buxhetit qendror

5.1 Të gjitha të hyrat vetjake të organizatave të Qeverisë qendrore që përbëhen, por që nuk kufizohen vetëm në pagesat dhe taksat e shfrytëzuesve, duhet të deponohen në një llogari të veçantë në Fondin e Konsoliduar të Kosovës. Në këtë Rregullore shprehja “pagesat dhe taksat për shfrytëzim” është përkufizuar si pagesa të pranuar nga organizata e buxhetit qendror për mallrat dhe shërbimet e ofruara për institucionet joqeveritare apo personave.

5.2 Ministri i Ekonomisë dhe i Financave është i autorizuar që të nënshkruajë memorandum mirëkuptimi me organizatën buxhetore për të trajtuar:

(a) Procedurat për mbledhjen, harmonizimin dhe depozitimin e të hyrave në Fondin e Konsoliduar të Kosovës;

(b) Shumën apo përpjesëtimin e të hyrave që do t'i ndahen organizatës buxhetore dhe

(c) Shpenzimet nga të hyrat vetjake që do të kufizohen vetëm në të hyrat e pranura pas datës së nënshkrimit të memorandumit të mirëkuptimit.

5.3 Ministri për Ekonomi dhe Financa ia dorëzon një kopje të nënshkruar të memorandumit të mirëkuptimit të cekur në nenin 5.2 Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm dhe Kuvendit.

5.4 Organizatat buxhetore janë përgjegjëse për mbledhjen, depozitimin dhe harmonizimin me Thesarin, në përputhje me procedurat në memorandumin e mirëkuptimit të miratuar paraprakisht. Shuma e autorizuar e ndarjes buxhetore nuk duhet të tejkalojë vlerën e të hyrave të saktësuara që janë depozituar në Fondin e Konsoliduar të Kosovës.

5.5 Të gjitha ndryshimet në të hyra dhe në ndarje buxhetore që dalin nga ky memorandum i mirëkuptimit përfshihen në raportet përfundimtare të përshkruar në nenin 3.3 të përgatitur nga Ministria për Financa dhe Ekonomi.

Neni 6

Ndarja dhe rindarja e tepricave të bartura të fondeve

6.1 Jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas ndarjes së plotë buxhetore për vitin 2008, Qeveria ia paraqet Kuvendit dhe Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm një pasqyrë fillestare që thekson shumat, burimet dhe shfrytëzimet e përgjithshme të elementeve të fondeve të bartura si teprica nga viti fiskal 2007 duke përfshirë:

(a) Tepricën e pashpenzuar të të hyrave vetjake të Qeverisë qendrore;

(b) Tepricën e pashpenzuar të të hyrave vetjake të komunës;

(c) Tepricën e pashpenzuar të granteve të caktuara nga donatorët;

- (d) Tepricën e pashpenzuar të parave publike të mbajtura nga AKM-ja lidhur me administrimin e ndërmarrjeve shoqërore dhe pasurive të ngjashme nga ana e saj;
- (e) Tepricat e “fondeve të besimit” që ruhen nga organizatat buxhetore dhe
- (f) Cilatdo fonde që ruhen si fitime të mbetura.

6.2 Tepricat e pashpenzuara të “të hyrave vetjake të Qeverisë qendrore” nga viti fiskal 2007 dhe më herët, deri në shumën e depozituar në Fondin e Konsoliduar të Kosovës dhe të evidencuara në regjistrin kontabël të Thesarit si mjete buxhetore të ndara për Qeverinë qendrore, ndahen dhe autorizohen për vitin fiskal 2008.

6.3 Tepricat e pashpenzuara të “të hyrave vetjake të komunës” nga viti fiskal 2007 dhe më herët, deri në shumën e depozituar në Fondin e Konsoliduar të Kosovës dhe nëse janë të evidencuara në regjistrin kontabël të Thesarit si mjete buxhetore të ndara për komunën, ndahen dhe autorizohen për vitin fiskal 2008.

6.4 Tepricat e pashpenzuara të granteve të caktuara të donatorëve, që janë pranuar dhe janë evidencuar në regjistrin kontabël të Thesarit në vitin 1999-2007, ndahen dhe autorizohen për vitin fiskal 2008.

6.5 Tepricat e pashpenzuara të “fondit të mirëbesimit” për vitin fiskal 2007 dhe më herët, deri në shumën e depozituar në Fondin e Konsoliduar të Kosovës dhe nëse janë të evidencuara në regjistrin kontabël të Thesarit si ndarje buxhetore për Qeverinë qendrore, ndahen dhe autorizohen për vitin fiskal 2008.

6.6 Në pajtim me Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi të shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/17, të gjitha dhurimet, huatë dhe grantet do të depozitohen në Fondin e Konsoliduar të Kosovës dhe do të konsiderohen si pjesë e tij, përveç rasteve kur Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm vendos ndryshe. Pas përfundimit të procedurës së nxjerrë nga Departamenti i Thesarit në Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave dhe pas depozitimit të tyre në Fondin e Konsoliduar të Kosovës, dhurimet, huatë dhe grantet e tilla konsiderohen se janë ndarë për qëllim apo qëllime të caktuara dhe mund të ndahen dhe shpenzohen për qëllimin apo qëllimet e tilla, përveç rasteve kur Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm vendos ndryshe.

6.7 Nëse një marrëveshje për grant e arritur nga UNMIK-u, në konsultim me Qeverinë, me Agjencinë Evropiane për Rindërtim ose me Bankën Botërore obligon dhënësin e grantit për kompensim të shpenzimeve të caktuara të grantit të

donatorit për organizatën buxhetore pranuese pas kryerjes së veprimit, shuma e plotë e grantit do të konsiderohet se është ndarë me arritjen e marrëveshjes për grantin për një qëllim të saktësuar ose qëllime të saktësuara dhe mund të alokohen e të shpenzohen për qëllimin apo qëllimet e tilla, në pajtim me rregullën financiare të lëshuar nga Departamenti i Thesarit. Shuma e grantit të ndarë, të alokuar dhe të shpenzuar do t'i kompensohet më pas plotësisht Fondit të Konsoliduar të Kosovës nga burimet e parapara përmes marrëveshjes mbi grantin.

6.8 Departamenti i Thesarit do të përcjellë dhe do të sigurojë raporte tremujore mbi shumën e çfarëdo shpenzimi të lidhur me ndarjen buxhetore të bërë sipas nenit 6.4, për grantet e pranuar gjatë vitit fiskal 2008 dhe për shpenzimet nga neni 6.7 për të cilat pritet të pranohen fondet nga donatori si kompensim për një shpenzim të tillë.

6.9 Të gjitha paratë publike të mbajtura nga AKM-ja lidhur me administrimin e ndërmarrjeve shoqërore dhe pasurive të ngjashme dhe çdo pagesë nga kapitali themelues i AKM-së regjistrohen me kohë dhe konsiderohen si pjesë e Fondit të Konsoliduar të Kosovës, në pajtim me rregulloret e ndryshuara të UNMIK-ut nr. 2002/12, 2002/13 dhe 2003/13. Paratë e tilla publike të mbajtura nga AKM-ja konsiderohen se janë ndarë për qëllimin apo qëllimet e caktuara, të autorizuar sipas ligjit në fuqi dhe mund të ndahen e të shpenzohen për qëllimin apo qëllimet e tilla.

6.10 Të gjitha paratë publike të mbajtura nga AKP-ja përkitazi me ushtrimin e përgjegjësisë së saj në hartimin, zbatimin dhe në administrimin e skemës së qiradhënies lidhur me pronat që AKP-ja i ka në listën e saj dhe çdo pagesë e ndërlidhur nga llogaria e AKP-së duhet të regjistrohet dhe të llogaritet si pjesë e Fondit të Konsoliduar të Kosovës në përputhje me kornizën ligjore të AKP-së, me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësisë dhe me rregullat financiare në fuqi. Paratë e tilla publike të mbajtura nga AKP-ja konsiderohen se janë ndarë nga buxheti për qëllim specifik apo për qëllime specifike të autorizuar sipas ligjit në fuqi dhe sipas skemës së qiradhënies së AKP-së dhe mund të alokohen e shpenzohen për atë qëllim apo për ato qëllime.

6.11 Të gjitha paratë publike të depozituara nga Radiotelevizioni i Kosovës (RTK) në Fondin e Konsoliduar të Kosovës në pajtim me nenin 19.1 të Ligjit mbi Radiotelevizionin e Kosovës, të shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/14 të datës 11 prill 2006, konsiderohen se janë ndarë për shfrytëzim nga RTK-ja në bazë të politikave dhe procedurave, duke përfshirë edhe ato të prokurimit, që do të caktohen nga Bordi i RTK-së në përputhje me ligjin në fuqi dhe mund të alokohen dhe shpenzohen për qëllime të RTK-së, përveç pesë përqindëshit (5%) të pagesës për transmetimin publik, e cila do t'i ndahet Zyrës së Kryeministrit lidhur me përkrahjen e medieve të pakicave, atyre shumetnike dhe

atyre që janë të disfavorshme. Procedurat themelore për zbatimin e kësaj marrëveshjeje caktohen nga drejtori i Thesarit në bashkërendim me bordin e RTK-së.

6.12 Të gjitha paratë publike të mbajtura nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRE) dhe Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit (ART) duhet të regjistrohen dhe të llogariten si pjesë e Fondit të Konsoliduar të Kosovës. Këto para të mbajtura nga ZRE-ja dhe ART-ja konsiderohen se janë ndarë për qëllim apo për qëllime të autorizuar sipas ligjit në fuqi dhe mund të alokohen e të shpenzohen për qëllim apo qëllime të tilla në përputhje me buxhetin e miratuar nga Kuvendi, duke marrë plotësisht parasysh kushtet e parapara me ligjin në fuqi. Buxheti për ZRE-në dhe për ART-në i miratuar nga Kuvendi do të paraqitet në pasqyrat e bashkëngjitura kësaj Rregulloreje.

6.13 Çdo tre muaj RTK-ja, AKP-ja, ART-ja dhe ZRE-ja ia paraqesin Kuvendit të Kosovës raportin e hollësishëm mbi të hyrat dhe shpenzimet e parave publike të depozituara në FKK dhe të ndara në përputhje me nenet 6.10, 6.11 dhe 6.12.

6.14 Të gjitha paratë publike që janë të karakterit të mirëbesimit dhe që pranohen nga organizatat buxhetore duhet të regjistrohen dhe të llogariten si pjesë e Fondit të Konsoliduar të Kosovës në përputhje me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi dhe me rregullat financiare në fuqi. Paratë e tilla publike që janë të karakterit të “fondit të mirëbesimit” konsiderohen se janë ndarë për qëllim apo qëllime specifike të kthimit të fondeve të tilla të mirëbesimit pronarëve të tyre përfitues dhe mund të alokohen e të shpenzohen për qëllime të tilla.

Neni 7

Kufizimet mbi zotimet dhe shpenzimet

7.1 Shpenzimet dhe zotimet nga Fondi i Konsoliduar i Kosovës bëhen vetëm:

(a) Nga shuma e cila është ndarë për këtë qëllim dhe

(b) Në pajtim me kushtet e tjera të kësaj Rregulloreje dhe me nenin 8 të Ligjit mbi prokurimin publik (Ligji nr. 2003/17) i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/3 të datës 9 shkurt 2004.

7.2 Nga çdo organizatë buxhetore kërkohet të garantojë që numri i personelit të saj të punësuar në vitin 2008 të mos tejkalojë në asnjë kohë të vitit fiskal nivelin e

punësimit siç është paraparë në pasqyrën 2 që i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje. Po ashtu, çdo organizatë buxhetore kërkohet të garantojë se numri i pozitave të saj të punëtorëve nuk e tejkalon asnjëherë gjatë vitit fiskal 2007 nivelin e 31 dhjetorit 2006, përveç nëse parashihet ndryshe në pasqyrën 2 të kësaj Rregulloreje. Nga çdo organizatë buxhetore kërkohet që t'i menaxhojë nivelet e veta të punësimit për vitin 2008 për të garantuar që fondet e ndara për “paga dhe rroga” të jenë të mjaftueshme për financimin e niveleve të punësimit për vitin 2008 që janë paraqitur përmes kësaj Rregulloreje. Çdo organizatë buxhetore duhet t'ia dorëzojë planin e punësimit Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë jo më vonë se më 31 janar 2008, duke treguar se si parasheh që ta menaxhojë nivelin e saj të punësimit në përputhje me këtë nen.

7.3 Ministri i Financave dhe i Ekonomisë, sipas nevojës dhe me kërkesë të Qeverisë, mund të autorizojë rritjen ose zvogëlimin e numrit të personelit të organizatës buxhetore të saktësuar në pasqyrën 2 që i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje. Autorizimi në këtë nen nuk nënkupton as nuk autorizon ndonjë ndryshim në ndarjet për pagat dhe rrogat. Ndryshimet e tilla do të përfshihen në shqyrtimin e ardhshëm të pasqyrave të buxhetit të miratuara nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm në përputhje me nenin 3. Një rritje e numrit të personelit të organizatës buxhetore do të autorizohet vetëm nëse organizatës buxhetore i është dhënë një përgjegjësi e re ose shtesë, e cila nuk ka mund të planifikohet në mënyrë të arsyeshme në kohën e përgatitjes së Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitin 2008.

7.4 Mosrespektimi i kufirit lidhur me numrin e pozitave të të punësuarve është shkelje e kësaj Rregulloreje dhe e Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi të shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/17. Dënimet e parapara me atë Ligj shqiptohen në mënyrë strikte ndaj çdo individi i cili është përgjegjës për shkelje të tillë.

7.5 Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale i kufizon pagesat sipas kategorisë ekonomike të “subvencioneve dhe transfereve” ashtu që të mos kalojë shumat e përgjithshme të fondeve për “subvencione dhe transfere” për vitin 2008 që i janë ndarë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale ashtu siç janë paraqitur në pasqyrën 2 të kësaj Rregulloreje. Nëse detyrimet e përgjithshme të shpenzimeve i tejkalojnë shumat e ndara për vitin 2008, Ministri i sekuestron pagesat për të siguruar që shumat e siguruar aty nuk tejkalohen, përveç nëse në mënyrë eksplicite autorizohen nga Qeveria për secilin rast veçmas. Në bashkërendim me Qeverinë, Kuvendin dhe me Këshillin Ekonomik dhe Fiskal, Ministri cakton mënyrën dhe formulën më të mirë për sekuestrimin e pagesave të tilla për “subvencione dhe transfere”.

7.6 Fondet e ndara për Ministrinë e Komuniteteve dhe Kthimeve në kuadër të kategorisë ekonomike “shpenzimet kapitale” në tabelën A të pasqyrës 2 zotohen dhe shpenzohen vetëm varësisht nga autorizimi i komisionit që përbëhet prej Ministrisë, Zyrës së Kryeministrit, programit për zhvillim të Kombeve të Bashkuara, Zyrës për komunitete, kthime dhe çështje të pakicave dhe Komisionerit të Lartë për Refugjatë të Kombeve të Bashkuara, në përputhje me mekanizmin qendror për rishikim të themeluar nga UNMIK-u në korrik të vitit 2005.

7.7 Organizata buxhetore nuk lëshon ftesë për tender për një projekt të miratuar kapital ashtu siç është identifikuar në pasqyrën 4 pas 31 tetorit 2008 për shpenzime të mundshme në vitin 2008, përveç nëse shpenzimet janë parashikuar për një projekt të tillë kapital për vitin 2009 ose 2010 në pasqyrën 4 ose shpenzimet janë autorizuar nga Ministri për Financa dhe Ekonomi.

7.8 Propozimi nga organizata buxhetore për t’iu paguar shtesa punëtorëve i dërgohet Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për miratim para se të zotohen apo të shpenzohen shtesat. Pas konsultimeve me Qeverinë, Ministri i Financave dhe Ekonomisë këto propozime ose i miratohen ose i refuzon brenda 60 ditësh nga marrja e propozimit. Shtesat do të paguhen nga shpenzimet e autorizuara për “paga dhe rroga”.

7.9 Fondet do të ndahen për konfiskimet e autorizuara ashtu siç parashihet në pasqyrën 2 dhe do të miratohen nga Kuvendi. Fondet e ndara kështu do të autorizohen për shpenzime në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe në bazë të një pasqyre që pritet të miratohet nga Qeveria ku do të specifikohen shumat e caktuara që u ndahen organizatave buxhetore në fjalë që janë përgjegjëse për konfiskimin.

Neni 8

Shpenzimet dhe rezervat e paparashikuara

8.1 Shumat e autorizuara për shpenzime të paparashikuara mund të përdoren vetëm për kërkesa urgjente dhe të paparashikuara.

8.2 Fondet për shpenzimet e paparashikuara ndahen si:

(a) “Rezervë Ministrit të Financave dhe të Ekonomisë” në tabelën A të pasqyrës 2. Shumat mund të transferohen nga ndarjet për shpenzime të paparashikuara si vijon:

- (i) Transferet e shumave më pak apo baras me €250,000 nga “rezervat e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë” do të autorizohen nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë pas marrjes së arsytimit të duhur;
- (ii) Transferet e shumave më të mëdha se €250,000 nga “rezervat e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë” do të autorizohen nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë pas marrjes së arsytimit të duhur dhe pas miratimit nga Qeveria dhe

(b) “Rezerva për zbatimin e statusit” në tabelën A të pasqyrës 2. Fondet e ndara si “rezervë për zbatimin e statusit zotohen, obligohen dhe shpenzohen vetëm në përkrahjen e përgjegjësive të reja të Qeverisë përkitazi me statusin. Këto fonde do të lëshohen vetëm për programe, projekte dhe funksione specifike, ashtu siç do të përcaktohet nga Ministri për Financa dhe Ekonomi në një plan të miratuar nga Qeveria dhe Kuvendi. Brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh kalendarik, Kuvendi e miraton apo e refuzon planin. Ai mund të kërkojë sqarime shtesë. Në rastin e tillë afati kohor nga Kuvendi mund të shtyhet për dhjetë (10) ditë kalendarike nga dita kur pranohen sqarimet shtesë. Nëse nga Kuvendi nuk ndërmerret asnjë veprim brenda afatit kohor të përshkruar në këtë nen, plani konsiderohet se është miratuar nga Kuvendi dhe

(c) “Rezervë Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm” në tabelën B të pasqyrës 2. Transferimet e shumave nga “Rezerva për Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm” autorizohen shprehimisht nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

8.3 Ministri i Ekonomisë dhe i Financave i paraqet Kuvendit raport tremujor mbi shfrytëzimin e shpenzimeve të paparashikueshme.

Neni 9

Transferimi i shumave të ndara

9.1 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, pas konsultimeve me Qeverinë, mund të autorizojë një transferim të shumave të ndara midis tabelave A, B dhe C të pasqyrës 2.

9.2 Ministri i Financave dhe Ekonomisë, nëse ka një arsyetim valid nga drejtori i organizatës buxhetore, mund të autorizojë transferimin e një pjese të një ndarjeje për atë organizatë buxhetore në një ndarje tjetër të asaj organizate buxhetore, në përputhje me nenin 27 të Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësive të shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/17. Ministri i

Financave dhe Ekonomisë nuk autorizon transferimin e shumave nga kategoria ekonomike “shpenzimet kapitale” në ndonjë kategori tjetër ekonomike në pasqyrën 2 më të madhe se 5 % nga ndarja e prekur negativisht.

9.3 Pavarësisht nga neni 9.2, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, me kërkesë të drejtorit të organizatës buxhetore me kompetenca të rezervuara, mund të autorizojë transferin e shumës më të madhe se njëzet për qind (20%) të ndarjeve buxhetore të prekura negativisht të asaj organizate, pas konsultimit me Ministrin e Financave dhe Ekonomisë.

9.4 Pas miratimit, duhet të bëhet përmirësimi i shumave të ndara në pasqyrën 2 në regjistrin kontabël të Thesarit nga ana e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë. Këto ndryshime duhet të përfshihen në rishikimin e ardhshëm të pasqyrave buxhetore të miratuara nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm në përputhje me nenin 3.

9.5 Me bartjen e përgjegjësiave nga UNMIK-u në Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes, buxheti relevant nga organizata buxhetore me kompetenca të rezervuara do të bartet në një organizatë të re buxhetore, e cila merr përgjegjësitë në pajtim me nenin 9.1.

9.6 Jo më vonë se 29 shkurt 2008, Ministri i Financave dhe Ekonomisë i dërgon Kuvendit dhe Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm një pasqyrë ku tregohen të gjitha fondet e shpenzimeve kapitale të pashpenzuara nga pasqyra 2 dhe pasqyra 4 e Rregullores mbi buxhetin 2006/61. Në pajtim me këtë nen fondet e pashpenzuara për organizatat buxhetore të cilat kanë nënshkruar kontrata jo më vonë se 31 dhjetor 2007 do të rindahen për shfrytëzim në vitin 2008 sipas kushteve të njëjta të parapara për shfrytëzim në vitin 2007. Këto fonde ndahen për shpenzim menjëherë pas nxjerrjes së kësaj pasqyre. Këto rindarje do të paraqiten në mënyrën e duhur në cilindo ndryshim të mëvonshëm të buxhetit.

Neni 10

Transferimi i shumave të ndara për projekte kapitale

10.1 Për projekte kapitale të identifikuar në pasqyrën 4, Ministri i Financave dhe Ekonomisë mund të autorizojë transferimin e fondeve nga një projekt kapital në projektin tjetër kapital të asaj organizate buxhetore nëse i sigurohet arsyetim valid nga shefi i organizatës buxhetore, me kusht që shuma e transferuar të jetë më e vogël apo baras me njëzet për qind (20 %) të shumës së përgjithshme të ndarë për projekte kapitale të asaj organizate buxhetore në pasqyrën 2.

10.2 Transferimi i një shume më të madhe se njëzet për qind (20 %) por më e vogël se 40 për qind (40 %) e shumës së përgjithshme të ndarë për projekte kapitale të asaj organizate buxhetore në pasqyrën 2 mund të autorizohet nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë vetëm pasi që të merr miratimin me shkrim nga Qeveria dhe nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

10.3 Transferimi i një shume baras apo më të madhe se katërdhjetë për qind (40 %) i shumës së përgjithshme të ndarë për projekte kapitale të asaj organizate buxhetore në pasqyrën 2 mund të autorizohet nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë vetëm pasi që të merr miratimin me shkrim nga Kuvendi dhe nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

10.4 Pavarësisht nga nenet e mëparshme, transferimi i shumave të ndara për projekte kapitale të organizatave buxhetore komunale, ashtu siç është paraqitur në pasqyrën 2 mund të autorizohet nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë vetëm pasi që të merr miratimin me shkrim nga kuvendi përkatës komunal.

10.5 Transferimi nga një projekt kapital në tjetrin projekt kapital mund të autorizohet nëse projekti kapital që merr financimin shtesë është shqyrtuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë në kontekstin e programit publik për investime.

Neni 11

Parashikimi i buxhetit për ligjet e propozuara

Në kohën kur Qeverisë i dorëzohet propozimi për përgatitjen e një ligji, organizata buxhetore që bën një propozim të tillë do të paraqesë në Qeveri edhe një parashikim mbi shpenzimet financiare të ligjit në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2008 si dhe në buxhetin për jo më pak se dy vitet pasuese. Parashikimet e shpenzimeve financiare duhet të përmbajnë të gjitha shpenzimet dhe të hyrat buxhetore të planifikuara. Ministria për Financa dhe Ekonomi do të jetë përgjegjëse për verifikimin ose ndryshimin e parashikimit të shpenzimeve të tilla financiare. Nëse janë paraparë shpenzime shtesë, nga organizata buxhetore mund të kërkohet që të absorbojë shpenzimet e tilla shtesë brendapërbrenda burimeve të buxhetit të saj të miratuar për vitin 2008.

Neni 12

Kredi për subjektet e caktuara

Në pajtim me nenin 44.4 të Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/17 dhe të

ndryshuar më vonë, Ministri i Financave dhe Ekonomisë ka autoritetin që subjektit të caktuar të paraqitur në pasqyrën A të Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi të sigurojë një hua të kthyeshme apo kredi nga Fondi i Konsoliduar i Kosovës, në shumën dhe sipas kushteve për të cilat është arritur pajtim me Qeverinë dhe Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm. Shumat maksimale të miratuara për kreditë ose huatë e tilla janë përcaktuar në pasqyrën 2. Huaja apo kredia e kthyeshme do të bazohet në një marrëveshje të arritur në mes të subjektit të caktuar i cili e merr huanë apo kredinë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të miratuar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, sipas nevojës, dhe do të përdoret vetëm për qëllime të shpenzimeve kapitale.

Neni 13

Shuarja e fondeve dhe e ndarjeve të mjeteve buxhetore

Përveç rasteve kur kjo Rregullore parasheh rindarje të mjeteve buxhetore, ndarjet e mjeteve buxhetore dhe rishpërndarjet e fondeve të bëra në vitin fiskal 2008 shuhen automatikisht në mesnatën e 31 dhjetorit të vitit 2008, përveç kur Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, në rrethana të jashtëzakonshme me kërkesë të Qeverisë mund të autorizojë ndryshe.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi më 1 mars 2008.

Joachim Rucker
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

Pasqyra 1

Buxheti i Konsoliduar i Kosovës 2008
(bashkëngjitur)

Pasqyra 2

Ndarjet e Buxhetit të Përgjithshëm të Kosovës 2008

(bashkëngjitur)

Tabela A: Organizatat buxhetore të IPVQ-ve

Tabela B: Organizatat buxhetore me kompetenca të rezervuara

Tabela C: Organizatat buxhetore që janë komuna

Tabela D: Përmbledhje e ndarjeve buxhetore

Tabela E: Organizatat buxhetore të Qeverisë Qendrore

Pasqyra 3

Buxheti i Përgjithshëm i Kosovës 2008

Financim me ndarje të drejtë. Propozimi për kërkesat minimale të alokimeve

(bashkëngjitur)

Pasqyra 4

Buxheti i Përgjithshëm i Kosovës 2008

Shpenzimet kapitale të organizatave buxhetore qendrore dhe lokale 2008

(bashkëngjitur)